

	<p>Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo</p> <p>Komuna e Prishtinës Opština Priština – Municipality of Prishtina</p>	<p>PRISHTINA</p> 
---	--	--

Datë/a:	13.12.2019
Referencë:	05nr.350/02 - 25323/19 dt.05.02.2019,
Për/ Za/ To:	1. Agjencia e Kosovare e Privatizimit, rr."Ilir Konushevc" nr.8, Prishtinë. 2. Ardit Rexha, rr. "Mujë Krasniqi", Lagjja "Ulpiana - U1", H-4, nr.15 Prishtinë.
CC:	Drejtori: Ardian Olluri, U.D. Udhëheqëse e Sektorit
Nga/ Od/ From:	Drejtoria e Urbanizmit
Përmes/Preko/Through:	Qendrës për Shërbim me Qytetarë
Zyrtari:	Ergyn Hajredini.
Tema/ Subjekat/Subject:	Njoftim





Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës përmes kësaj shkrese informon, Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe Ardit Rexhën nga Prishtina, se me Vendimin 05nr.350/02 – 223692/19 dt.13.12.2019, ka caktuar kushtet ndërtimore Ministrisë së Administratës Publike të Qeverisë së Republikës së Kosovës, sipas kërkesës për kushte ndërtimore, 05nr.350/02 – 223692/19 dt.11.09.2019, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor për ndërtimin e **“Kompleksi i ri i Radio Televizionit të Kosovës – RTK-së”** me etazhitet B+S+P+3, në kuadër të Bllokut urban “B-5”, Tërësia “B” – Tipologjia “G” të Planit Rregullues “Prishtina e Re – Zona Qendër” në Prishtinë, konkretisht parcelës kadastrale nr.556-5 ZK Çagllavicë, me pronar / posedues, P.SH. KK Prishtinë, sipas projekt propozimit / Plani i situacionit - “zgjdhjes urbane” të prezantuar.

Pasi pjesët e parcelave kadastrale, nr.1014-1 ZK Matiçan me pronar / posedues “KBI Kosova” në menaxhim të AKP-së dhe pjesa e parcelës nr.1014-2 ZK Matiçan me pronar / posedues, Ardit Rexha, shtrihen në afërsi të kompleksit të lartë cekura, gjegjësisht në të njëjtin bllok urban, përmes kësaj shkrese ju informon se, bazuar në rregullativën ligjore në fuqi, Vendimin e kushteve ndërtimore 05nr.350/02 - 223693/19 dt.13.12.2019, Komuna e Prishtinës do ta publikoj në Web faqe e sajë, për sigurimin e qasjes së publikut në sistemin e vrojtimit, ku publikut do ti mundësohet qasja në kushte ndërtimore, parametrat urban të përcaktuar dhe baza ligjore, dhe mënyra e caktimit të tyre.

Njëherë ju informojmë se bazuar në rregullativën ligjore në fuqi, konkretisht Ligjit Nr.03/L-215 për qasje në dokumente publike, palët e interesuara sipas kërkesës drejtuar në Komunën e Prishtinës, mund të kenë qasje në dokumente publike, konkretisht në vendimin e kushteve ndërtimore të lartë cekura.

I dërgohet: Agjencisë Kosovare të Privatizimit – AKP-së, Ardit Rexhës nga Prishtina si dhe vendosje në dosje të lëndës 05nr.350/02 – 223693/19 dt.11.09.2019, kësaj drejtorie dhe Qendrës për shërbim me qytetarë.

	<p>Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo</p> <p>Komuna e Prishtinës Opština Priština – Municipality of Prishtina</p>	
---	--	---

Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 23.08.2013, nenit 18 të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 21, 44, 57 & 140 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-03, dt.21.06.2016, nenit 17, pika “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dt. 20.02.2008 dhe nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, Udhëzimit Administrative të MMPH-së Nr.06/2017 dt. 23.05.2017, për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, si dhe duke vendosur sipas kërkesës, 05nr.350/03 – 223693/19 dt.11.09.2019, të kërkuesit Ministria e Administratës Publike e Qeverisë së Kosovës në Prishtinë, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor për ndërtimin e **“Kompleksi i ri i Radio Televizionit të Kosovës – RTK-së”** në kuadër të Bllokut urban “B-5”, Tërësia “B” – Tipologjia “G” të Planit Rregullues “Prishtina e Re – Zona Qendër” në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit në procedurë të rregullt administrative me datë 13.12.2019, merr këtë:

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE

I. I caktohen kushtet ndërtimore kërkuesit, Ministria e Administratës Publike e Qeverisë së Kosovës në Prishtinë, sipas kërkesës për kushte ndërtimore, 05nr.350/02 – 223692/19 dt.11.09.2019, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor për ndërtimin e **“Kompleksi i ri i Radio Televizionit të Kosovës – RTK-së”** me etazhitet B+S+P+3, në kuadër të Bllokut urban “B-5”, Tërësia “B” – Tipologjia “G” të Planit Rregullues “Prishtina e Re – Zona Qendër” në Prishtinë, konkretisht parcelës kadastrale nr.556-5 ZK Çagllavicë, me pronar / posedues, P.SH. KK Prishtinë.

II. Lokacioni i kompleksit të parcelave për të cilin caktohen kushtet ndërtimore, përfshihet në kuadër të Bllokut urban “B-5”, Tërësia “B” – Tipologjia “G” të Planit Rregullues “Prishtina e Re – Zona Qendër” në Prishtinë, miratuar me Vendimin e KK Prishtinë 01 nr.035 - 186861 dt.02.10.2013, dhe sipas këtij plani kjo zonë është e destinuar “Destinim publik”, si dhe në kuadër të Planit Zhvillimor Urban, miratuar me Vendimin e KK Prishtinë, 01nr.035-181427 dt. 24.09.2013;

III. Gjendja ekzistuese e lokacionit/parcelës së lartcekur sipas gjendjes, kadastrale, pronësore, faktike & planifikimit urban është:

- Numri, sipërfaqja, pronari & klasa e kualitetit të parcelës kadastrale, janë:
 - nr.556-5; S=87459m²; P.SH. KK Çagllavicë; “Arë e klasit 7”;
 - Totali i parcelave private: S=87459m².
- E drejta pronësore - juridike e parcelës së lartcekur , është P.SH. Kuvendi Komunal Prishtinë , në bazë të kopjes së planit dhe certifikatës së njësisë kadastrale të evidencës kadastrale;
- Parcela kadastrale nr.556-5 ZK Çagllavicë, përfshihet edhe në hapësira publike dhe blloqe fqinje të planit rregullues;
- Në kuadër të parcelës kadastrale nr.556-5 ZK Çagllavicë nuk ka ndërtesa të ndërtuara ;
- Terreni ka pjerrtësi /disnivel nga drejtimi veri – jug, me nivel ~24.00m’;
- Qasja ekzistues e parcelës kadastrale nr.556-5 ZK Çagllavicë është përmes rrugëve lokale të pa asfaltuar dhe asfaltuar, të cilat nga këto rrugë disa janë edhe rrugë e planifikuar e planit rregullues urban;

- Brenda pjesës së Bllokut urban “B-5” Tërësia “B” të Planit Rregullue “Prishtina e Re – Zona Qendër” në Prishtinë, përfshihen edhe pjesët e parcelave kadastrale nr.556-1 ZK Çagllavicë me pronar / posedues P.SH. KK Prishtinë, pjesa e parcelës nr.1014-1 ZK Matiçan me pronar / posedues “KBI Kosova” në menaxhim të AKP-së dhe pjesa e parcelës nr.1014-2 ZK Matiçan me pronar / posedues, Ardit Rexha, për të cilën parcelë mungojnë shënimet e ndarjes;

- Në hapësirën e përfshirë në diametër prej 50 m` nuk ka ndërtesa ekzistuese;

IV. Kushtet e ndërtimit për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektit kryesor për rregullimin e hapësirës sipas gjendjes së planifikuar në kuadër të Parcelës ndërtimore në kuadër të pjesës së Bllokut urban “B-5”, Tërësia “B”, Tipologjia “G” të Planit Rregullues “Prishtina e Re – Zona Qendër” në Prishtinë, përcaktohen bazuar në parametrat, kriteret urban, kushtet për ndërtim për realizimin - ndërtimin e kompleksi me ndërtesë shumë banesore & afariste dhe hapësira përcjellëse, janë:

- Organizimi dhe qasja në kompleks, pozicionimi, gabaritet, etazhiteti i ndërtesës, raporti i ndërtesës me vijën rregulluese & ndërtimore, si dhe me distanca nga kufiri i parcelës, rrugët dhe vend parkingjet e planifikuara të kompleksit, si dhe kushtet tjera për rregullimin e hapësirës, të jenë në tërësi sipas prezantimit grafik të përshkruar në Planin e lokacionit - “zgjidhja urbane” bashkangjitura vendimit kushteve ndërtimore;

- Me këto kushte ndërtimore në kuadër të parcelës ndërtimore të Bllokut urban “B-5”, Tërësia “B” planifikohet të ndërtohet “Kompleksi i ri i Radio Televizionit të Kosovës – RTK”, me sipërfaqe ndërtimore dhe etazhitet, sipas kalkulimeve dhe projekt propozimit, si në vijim:

“Kompleksi i ri i Radio Televizionit të Kosovës – RTK-së”

Ndërtesa e RTK-së, S= 35,113.39m² / 30,639.29m², mbi tokë + 4,474.10 m², nën tokë /

Etazhitet: -B + S + P + 3 ,

- Parcela kadastrale për realizimin e “Kompleksi i ri i Radio Televizionit të Kosovës – RTK-së”, e trajtuara brenda vijës rregulluese, janë:

- nr.556-5; S=61,135.00m²;

- Pjesët e parcelës kadastrale të “Kompleksi i ri i Radio Televizionit të Kosovës – RTK”, të cilat shtrihen jashtë vijës rregulluese në hapësira publike dhe blloqe tjera të planit rregullues, janë:

- nr.556-5; S=22,451.00m²;

- Destinimi i shfrytëzimit të ndërtesës së kompleksit, të jetë për “Destinim publik” si dhe hapësira përcjellëse, si: kthina teknike, depo dhe hapësira garazhesh etj. (sipas projekt propozimit);

- Etazhiteti maksimal për Bllokun urban “B-5”, Tërësia “B” të Planit Rregullues “Prishtina e Re – Zona Qendër”, është II ÷ V etazhe mbi tokë (sipas projekt propozimit etazhiteti maksimal është, nga S+P+3);

- Koeficienti i shfrytëzimit i parcelës ndërtimore / parcelave kadastrale të bashkuara sipas grupeve-fazave në kompleks (ISHP), për vendosjen e ndërtesave në bazë-gabarit të përdhësës ose suteranit, lejohet max.40%:

S=61,135.00 x 0.4= 24,454.00m² / për pronën private /

S=7,136.80m² /sipas projekt propozimit/

- Koeficienti i shfrytëzimit të parcelës ndërtimore (ISHPN), për vendosjen e ndërtesës në bazë - gabarit të bodrumit është max.60%, bazuar në kriteret e planit rregullues dhe sipas kalkulimeve kjo sipërfaqe është:

S=61,135.00 x 0.6= 36,681.00m² / sipas planit rregullues/

S=1,084.04m² / sipas projekt propozimit/

- Në kuadër të kompleksit të planifikohen edhe hapësira me sipërfaqe gjelbëruese (ISGJ) min.40%, me gjelbërim të lartë & të ultë, dhe të organizuara për sport & rekreacion. Sipërfaqet gjelbëruese, sipas kalkulimeve dhe projekt propozimit, për kompleksin është:

S=61,135.00 x 0.4=24,454.00m² /sipas planit rregullues /

S=15,000.00m² / sipas projekt propozimit /

- Koeficienti i ndërtimit (ISPN) sipas Planit Rregullues “Prishtina e Re – Zona Qendër” është max.1.8, dhe trajtimi i sipërfaqeve ndërtimore për etazhet ndërtimore do të bëhet – llogaritet, si në vijim: **100%** për etazhet mbi kuotën ±0.00, 50% për etazhet me vëllim mbi **51%** apo së

paku njëra ballore mbi nivelin e tokës - **suteren** dhe **0%** për etazhet e nëntokës – **bodrum**, dhe kjo sipërfaqe është:

$S=61,135.00 \times 1.8=110,043.00\text{m}^2$ / për pronën private /

$S=30,639.29\text{m}^2$ / sipas projekt propozimit /

- Bazuar në nenin III. të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, protokolluar me numrin 01nr.031-185481 dt. 14.08.2016, për shkaqe të kursimit dhe efijencës së energjisë, sipërfaqja që zë shtresa e "termoizolimit", nuk përfshihet në kalkulimin e sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore e as në kalkulimin për taksë të lejes ndërtimore;
- Bazuar në kriteret e planit rregullues, distanca minimale ballore në mes të ndërtesave të jetë $1.0 \times H$ (ku H, është lartësia mbi tokë e ndërtesës), kurse e ndërtesës me kufirin e parcelës fqinje $0.5 \times H$ ose min. 7m, ku distanca prej 7.0 m vlen edhe në rastet kur në atë fasadë nuk ka hapje – ndriçim primar për hapësirat e banimit (dhoma dite, fjetje, pune, tryezari, korridore të banesave, etj);
Distanca në mes të ndërtesave (shumë banesore apo afariste) te fasadat e kombinuara (njëra ndërtesë fasadë ballore, kurse tjetra ndërtesë fasadë anësore) lejohet distanca $0.6 \times H$;
- Ngritja e nivelit të përdheses nga niveli i terrenit- trotuarit të ndërtesës, lejohet max.1.2 m;
- Dalje me "konzollë" mbi etazhet e përdheses në këtë bllok urban nga ana e rrugëve publike – vijave ndërtimore, nuk janë të lejuara;
- Qasjet në komplekse të jenë nga rrugët e planifikuara e planit rregullues urban sipas planit të situacionit / zgjidhjes urbane të prezantuar dhe miratuar nga kjo drejtori;
- Në kuadër të kompleksit të parashihen edhe vend-parkimet e jashtme, shtigjet, trotualet kënde të lojërave për fëmijë, terrene sportive, mobiluar urban, etj.;
- Për çdo njësi banesore-rezidenciale të planifikohet 1.2 vend-parkime/një njësi banesore, kurse për pjesët afariste të ndërtesës, varësisht prej destinimit, të parashihen vend-parkimet, për çdo $1000\text{m}^2/40$ vend-parkime për shitore, banka, posta dhe të ngjashme, për çdo $1000\text{m}^2/20$ vend-parkime për administratë, për çdo $1000\text{m}^2/50$ vend-parkime për ndërtesa hoteliere, për çdo $1000\text{m}^2/30$ vend-parkime për ndërtesa kulturore dhe përmbajtje publike, si dhe për salla poli funksionale 20 ulëse / 1 vend-parkim;
- Në kuadër të kompleksit të parashihet hapësira për grumbullimin dhe vendosjen e mbeturinave;
- Si dhe aplikimi i të gjithave kushteve tjera urbane & arkitektonike të përcaktuara në kriteret & parametrat urban të Plani Rregullues "Prishtina e Re – Zona Qendër".
- Arkitektura-dukja e jashtme (fasada) e ndërtesave dhe materializimi i tyre, të jetë me materiale bashkëkohore dhe me masa të efijencës së energjisë, dhe ti përshtatet ambientit për rreth;

V. Ndarja / parcelimi i parcelës kadastrale nr.556-5 ZK Çagllavicë, do të realizohet sipas Manualin e ndarjes punuar nga gjeodeti i licencuar Fadil Shehu nga Prishtina.

Kjo drejtori përmes këtij paragrafi jep PËLQIM për ndarjen e parcelës kadastrale të lartcekura, sipas Manualit i ndarjes punuar nga gjeometri i licencuar. Procedura e ndarjes / parcelimit do të realizohet bazuar në pëlqimin e konfirmuar në këtë paragraf, i cili do të shërbejë si bazë për evidentimin në regjistrin kadastral, të këtyre ndryshimeve.

Kjo procedurë të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore, në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, sipas këtyre kushteve ndërtimore dhe me kërkesë të pronari / poseduesi, duke u bazuar edhe në, Plani i situacionit - "zgjidhja urbane" dhe "Situacioni i parcelave me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga plani rregullues në sistemin koordinativ KosovaREF01", punuar nga kjo drejtori, dhe Manuali i ndarjes punuar nga gjeodeti i licencuar Fadil Shehu nga Prishtina me numër të licencës nr.44, të cilat janë pjesë përbërëse e këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore.

VI. Kyçja në infrastrukturë - për marrjen e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR "Prishtina" aplikimi do të bëhet nga kjo drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kyçje në rrjetet përkatëse, i dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

- *Emri (prindi) Mbiemri i aplikuesit dhe numri i identifikimit dhe adresa;*
- *Informatën mbi lokacionin - adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;*
- *Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;*

- *Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në orto-foto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;*

- *Përshkrimin teknik të objektit (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për energji elektrike dhe ujësjellës).* Kyçja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kyçje nga "Termokos" - Ngrohtorja e Qytetit sh. dhe PTK-ja.

VII. Dokumentacioni ndërtimor - projekti kryesor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV., projekt propozimin e prezantuar, "Udhëzimit Administrativ i MMPH-së Nr.06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve", "Udhëzimit Administrativ MMPH-së 08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor", bazuar në UA nr. 33/2007 për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara, normave teknike për siguri nga zjarri si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, dhe të përmbajë:

- *Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;*
- *Situacionin - planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m`, me ndërtesa ekzistuese dhe ndërtesat e planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;*
- *Situacionin - planin e lokacionit 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë;*
- *Situacionin - "zgjdhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese, me kuota relative dhe absolute;*
- *Incizimin gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesave të projektuara dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;*
- *Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:50, për ndërtesat e projektuara, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese dhe etazheve tjera me kuota të shënuara, relative dhe absolute;*
- *Përshkrimin teknik me paramasë dhe parallogari të punëve ndërtimore dhe ndërtimore - zejtare;*
- *Detajet e nevojshme në përpjesë 1:5, 1:10 apo 1:20 dhe specifikimin e zdrukthëtarisë me përshkrimin e materialit të dyerve dhe dritareve, në përpjesë 1:50;*
- *Projektin e organizimit të kompleksit , me rrugë, shtigje, mobilian urban, etj;*
- *Projektin e strukturës së ndërtimit - llogarinë statike, me përshkrim teknik, pozicionim dhe detaje të nevojshme;*
- *Projektin e instalimeve elektro – energjetike, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin energjetik të qytetit dhe pozicionimin e trafo-stacionit;*
- *Projektin e instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;*
- *Projektin e instalimeve të makinerisë, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;*
- *Elaborati i "Organizmi dhe masat e sigurisë në vend ndërtim", bazuar në Vendimin 01 nr. 035-174324 dt. 12.07.2016 e Kryetarit të Komunës së Prishtinës;*
- *Elaboratin e fizikës ndërtimore dhe atë të mbrojtjes nga zhurma;*
- *Elaboratin gjeomekanik në bazë të analizave në terrenit;*

VIII. Dokumentacioni ndërtimor për Masat e mbrojtëse nga zjarri të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet nga kjo drejtori në kompetencë të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit të Komunës së Prishtinës, për sigurimin e "Deklaratë" për Masat e mbrojtjes nga zjarri. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- *Planin e mbrojtjes nga zjarri-elaboratin, të hartuar nga kompani apo individ i licencuar;*
- *Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);*
- *Situacionin-planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m`, me ndërtesa ekzistuese dhe ndërtesat e planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;*

- Situacionin-"zgjidhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese, me kuota relative dhe absolute;
- Kushtet ndërtimore, të caktuara nga Drejtoria e Urbanizmit (kopje);
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit të investitorit dhe të hartuesit të planit të mbrojtjes nga zjarri.

Dokumentacioni ndërtimor për Leje Mjedisore Komunale të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës, dhe aplikimi të bëhet në Drejtorinë e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, njëkohësisht me aplikimin për leje ndërtimore.

Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Raporti për Leje Mjedisore Komunale, në tre (3)kopje në formë të shkruar dhe një (1) në formë elektronike;
- Certifikatën për regjistrimin e biznesit;
- Certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit;

Kontratën për shfrytëzimin e parcelës, nëse parcela nuk është pronë e aplikuesit.

IX. Marrëveshja për infrastrukturë – bazuar në nenin 23 të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim dhe në nenin 10 dhe 11 të "Rregullore mbi Taksën administrative për dhënie e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës" 01nr.434/01–0094474/17 dt. 24.04.2017, obligohet Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave e Komunës së Prishtinës, të vlerësojë një ngarkesë për të ri-mbursuar koston për krijimin, përmirësimin, zgjerimin apo riparimin e infrastrukturës, dhe të arrijë marrëveshje për infrastrukturë me pronarin / investitorin.

Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet, nga kjo drejtori, në kompetencë të Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, për arritjen e kësaj marrëveshjeje. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Vendimi për caktimin e kushtet ndërtimore, së bashku me situacionin e miratuar, të lëshuar nga kjo drejtori;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit të kompanisë investuese;
- Kontratën për bashkë investim (nëse është prezantuar në kërkesën për leje ndërtimore);
- Autorizimin për përfaqësim (nëse është prezantuar në kërkesën e lejes ndërtimore);
- Kopjen e letërnjoftimit të kërkuësit/ve (bashkëpronarëve të parcelave & investitorit);

X. PAGESA E KOMPENSIMIT PËR NDËRRIMIN E DESTINIMIT TË TOKËS BUJQËSORE - meqenëse parcelat kadastrale nr.556-5 ZK Çagllavicë, në bazë të certifikatës së njësisë kadastrale, është e evidentuar me lloj të shfrytëzimit të parcelës-tokë bujqësore, me klasë të kualitetit "Arë e klasit 7", paraprakisht kërkohet të bëhet pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, konform nenit 11, 13 & 14 të Ligjit nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore dhe nenit 8, 9 & 14 të Udhëzimit Administrativ të MBPZHR Nr. 41/2006, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, që e rregullojnë këtë fushë.

Sipërfaqja e tokës bujqësore, të cilës do ti ndërrohet destinimi, do të përcaktohet bazuar në sipërfaqen që do të ndërtohet, gjegjësisht parcelës ndërtimore përcaktuar sipas Plani i situacionit – "zgjidhja urbane", dhe e njëjta do të përfshijë sipërfaqen e parcelës ndërtimore, prej S=61,135.00m². Kjo sipërfaqe do të regjistrohet si tokë ndërtimore, në regjistrin kadastral, pas realizimit të pagesës së kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore,

Ky kompensim - pagesë do të realizohet në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, në fazën e zhvillimit të procedurës administrative për marrjen e lejes ndërtimore.

XI. Vlefshmëria e vendimit të kushteve ndërtimore është një(1) vit, me mundësi të vazhdimit për një(1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor, dhe me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë.

Ar sy e t i m

Kërkuesi, Ministria e Administratës Publike e Qeverisë së Kosovës në Prishtinë, me kërkesën 05nr.350/02 – 223693/19 dt.11.09.2019, ka nga kjo drejtori caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor për ndërtimin e për ndërtimin e **“Kompleksi i ri i Radio Televizionit të Kosovës – RTK”**, në lokacionin e përhshkruar në paragrafin I. të dispozitiv të vendimit të kushteve ndërtimore.

Me kërkesën për kushte ndërtimore 05nr.350/02 – 223693/19 dt.11.09.2019, dhe plotësuar me shkresën “Plotësim lënde” 05nr.350/02 – 223693/19/1 dt.13.11.2019, si dhe gjatë fazës së zhvillimit të procedurës, është prezantuar dokumentacioni dhe provat si në vijim:

- Dëshminë mbi pronësinë: Kopjen e planit dhe Certifikatat e njësive kadastrale për parcelat kadastrale nr. 556-5 & 556-6 ZK Çagllavicë, lëshuar nga Drejtoria për Kadastër e Komunës së Prishtinës;
- Fotokopja e pa vërtetuar e “Vendim për Dhënien e Pronës së Paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim QRKS-së”, 01nr.046 – 94060 dt.04.05.2015;
- Fotokopja e pa vërtetuar e “Marrëveshje mirëkuptimi” e datës 13.04.2018, e lidhur në mes Komunës së Prishtinës dhe Ministrisë së Administratës Publike;
- Fotokopja e pa vërtetuar e “Marrëveshje mirëkuptimi” e datës 02.05.2018, në mes të Ministria e Administratës Publike dhe Radio Televizionit të Kosovës;
- Shkresat e këmbÿera përmes postës elektronike të datave: 02.10.2019, 03.10.2019, 10.10.2019, 11.10.2019, 18.10.2019, 30.10.2019, 31.10.2019, 01.11.2019 dhe 04.11.2019, të komunikimit në mes të përfaqësuesve të Ministrisë së Administratës Publike, Agjencisë së Privatizimit – AKP-së, Drejtorisë së Urbanizimit, ALB Architect, etj.
- Projekt propozimin konceptual, hartuar nga “Alb - Architect”sh.p.k. nga Prishtina dhe “North-West”sh.p.k. nga Prishtina, me projektues Adem Ibërhysaj nga Prishtina;
- Situacionin e terrenit në parcelën 556-5 ZK Çagllavicë, punuar nga Kompania gjeodezike Sh.PGJ.“Infa & Co.Group” nga Drenasi me licencë nr.17;
- Manualin e ndarjes së parcelës kadastrale nr.556-5 ZK Çagllavicë, punuar nga gjeodeti i licencuar Fadil Shehu nga Prishtina;
- Afishja “Njoftim publik” lëshuar nga kjo drejtori, ngas data 21.11.2019 gjer 06.12.2019;

Drejtoria e Urbanizimit, pas shqyrtimit të kërkesës 05nr.350/02 – 223693/19 dt.11.09.2019 plotësuar me shkresën “Plotësim lënde” 05nr.350/02 – 223693/19/1 dt.13.11.2019, dokumentacionin e prezantuar me kërkesa si dhe gjatë fazës së zhvillimit të procedurave administrative, konsultimit të rregullativës ligjore në fuqi nga lëmi i planifikimit, ndërtimit dhe procedurës së përgjithshme administrative, si pas konsultimit të dokumentit të planifikimit hapësinor–Plani Rregullues “Prishtina e Re–Zona Qendër”, në mënyrë kronologjike dhe procedurale, konstaton se:

Drejtoria e Urbanizimit, pas pranimit të kërkesës me dokumentacion përcjellës / projekt propozimin konceptuar me Planin e situacionit – “zgjidhjen urbane” dhe krahasimit të tije në raport me planin rregullues, konstatoi se parcela kadastrale nr.556-5 ZK Çagllavicë me pronar P.SH. – Kuvendi Komunal, përfshihet në kuadër të Bllokut urban “B-5”, Tërësia “B” – Tipologjia “G” të Planit Rregullues “Prishtina e Re – Zona Qendër” në Prishtinë, si dhe pjesërisht shtrihet edhe në hapësira publike (rrugë të planifikuar) dhe pjesërisht bllloqet fqinje të planit rregullues. Në kuadër të blllokut urban të lartë cekur përfshihet edhe pjesa e parcelës nr.556-1 ZK Çagllavicë me pronar / posedues P.SH. KK Prishtinë, pjesa e parcelës nr.1014-1 ZK Matičan me pronar / posedues “KBI Kosova” në menaxhim të AKP-së, si dhe pjesa e parcelës nr.1014-2 ZK Matičan me pronar posedues Ardit Rexha (për të cilat parcelë mungojnë shënimet e ndarjes), dhe se projekt propozimi i prezantuar nuk është në harmoni me kriteret e planit rregullues, andaj kjo drejtori përmes shkresës “Plotësim dokumentacioni” 05nr.351/02 – 223693/19 dt.26.09.2019 ka informuar dhe kërkuar nga kërkuesi që dokumentacionin e prezantuar ta plotësoj dhe korrigjoj si më poshtë:

- Bazuar në dokumentin e planifikimit hapësinor, parcela kadastrale nr.556-5 ZK Çagllavicë, për të cilin kërkohen kushte ndërtimore, përfshihet në kuadër të Blllokut urban “B-5”, Tërësia “B”, Tipologjia “G” dhe pjesërisht në Blllokut urban “B-6”, Tipologjia “G” dhe “B-13” Tipologjia “E”, Tërësia “B” të Planit Rregullues “Prishtina e Re – Zona Qendër” në Prishtinë, duke u përcaktuar, edhe: vijat rregullues dhe ndërtimore, si dhe kriteret dhe parametrat për ndërtim në kuadër të kësaj parcele, andaj dhe projekt propozimi duhet të hartohet në harmoni me kriteret dhe parametrat e planit rregullues.

- Bazuar në pozitën e parcelës kadastrale nr.556-5 ZK Çagllavicë, nëpër këtë parcelë shtrihen - kalojnë edhe destinomë publike të planit të planifikuar si: Rruga me prerje tërthore "B-B" dhe Kalimi me këmbësor me prerje "E-E", andaj për ndërtim në kuadër të Bllokut urban "B-5", Tërësia "B" – Tipologjia "G" të Planit Rregullues "Prishtina e Re – Zona Qendër", duhet të trajtohet parcela brenda vijave rregullues të këtij plani;

- Bazuar në evidencat kadastrale dhe pozitës së parcelave kadastrale në kuadër të Bllokut urban "B-5", Tërësia "B" – Tipologjia "G" të Planit Rregullues "Prishtina e Re – Zona Qendër", në këtë bllok urban përfshihen edhe pjesët e parcelave kadastrale nr.556-1 ZK Çagllavicë me pronar / posedues P.SH. KK Prishtinë, pjesa e parcelës nr.1014-1 ZK Matiçan me pronar / posedues "KBI Kosova" në menaxhim të AKP-së dhe pjesa e parcelës nr.1014-2 ZK Matiçan me pronar posedues Ardit Rexha, për të cilat parcela mungojnë shënimet e ndarjes, andaj në bashkëveprim me Drejtorin e Kadastrit duhet të definohen këto parcela. Andaj bazuar në kriteret e planit rregullues pjesë të këtij blloku-Bllokut "B-5" janë edhe këto pjesë të parcelave andaj të njëjtat duhet të trajtohen në kuadër të këtij blloku urban, apo të sigurohet pëlqimi nga pronarët / poseduesit e këtyre parcelave për mos trajtimin e tyre, pasi me mostrajtimin e tyre në këtë fazë, të njëjtave ju pamundësohet zhvillimi në të ardhmen sipas kriterëve të planit rregullues ;

ku në paragrafin e fundit të shkresës ka informuar palën / kërkuesin me afatin e plotësimit të shkresës, dhe se: "Pas prezantimit të dokumentacionit të kërkuar, harmonizimin e projektit konceptual – "zgjidhje urbane" dhe sqarimeve shtesë, bazuar në kërkesat dhe konstatimet e lartshënuara, kjo drejtori do të mund të ndërmerr veprimet ligjor për shqyrtimin e kërkesës me dokumentacionin e prezantuar dhe vendosjen e drejtë të kësaj çështje".

Ministria e Administratës Publike, pas pranimit të shkresës së lartë cekur (pranuar me datë 30.09.2019), dhe zhvillimit të disa procedurave të kërkuara, përmes shkresës "Plotësim lënde" 05nr.350/02 – 223693/19/1 dt.13.11.2019, ka prezantuar në Drejtorin e Urbanizimit pjesërisht dokumentacionin e kërkuar, gjegjësisht, shkresat e këmbyerat përmes postës elektronike sipas datave: 02.10.2019, 03.10.2019, 10.10.2019, 11.10.2019, 18.10.2019, 30.10.2019, 31.10.2019, 01.11.2019 dhe 04.11.2019, shkresa këto të komunikimit në mes të përfaqësuesit të Ministrisë së Administratës Publike me Agjencinë e Privatizimit – AKP-në, dhe Drejtorinë e Urbanizimit, projektuesit - ALB Architect, etj., si dhe ka prezantuar projekt propozimin e harmonizuar me kriteret e planit rregullues.

Drejtoria e Urbanizimit, pas kompletimit të dosjes së lëndës me kërkesë për kushte ndërtimore, në mbështetje të rregullativës ligjore në fuqi, konkretisht nenit 18 të Ligjit të Ndërtimit nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr.04/L-174 dt.31.07.2013 dhe nenin 13 të "Udhëzimi Administrativ i MMPH-së Nr.06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve", me datë 21.11.2019 ka vendosur afishen "Njoftimi publik" e cila ka qëndruar gjer me datë 06.12.2019, ku sipas rregullativës ligjore të lartë cekur para caktimit të kushteve ndërtimore, publiku i rrethinës duhet të informohet me synimin e kërkuesve dhe ofrimin e mundësin për dhënie të komenteve të pronarëve / poseduesve të rrethinës në diametrin e dritës prej 50m', në këtë rast edhe informimi i pronarëve/poseduesve të parcelave kadastrale nr.1014-1 ZK Matiçan të pronarit / poseduesit "KBI Kosova" në menaxhim të AKP-së, si dhe pronarit / poseduesit të pjesës së parcelës nr.1014-2 ZK Matiçan, Ardit Rexha. Gjatë kësaj periudhe në adresën e postës elektronike të vendosur në afişe nuk ka arritur ndonjë koment.

Bazuar në kriteret e planit rregullues, konkretisht vijave rregulluese të bllokut urban, konstatohet se nga sipërfaqja e gjithmbarshme e parcelës kadastrale nr.556-5 ZK Çagllavicë, prej S=87,459.00m², brenda Bllokut urban "B-5", përfshihet vetëm sipërfaqja prej S=61,135.00m², kurse pjesët tjera të parcelës përfshihen në hapësira publike(rrugë) dhe në blloqet urbane në rrethinë të planit rregullues, andaj të gjitha kalkulimet dhe plani i situacionit – "zgjidhja urbane" janë llogaritur dhe hartuar me sipërfaqen e parcelës ndërtimore – parcelës kadastrale e përfshirë brenda bllokut urban, kurse pjesët jashtë bllokut urban, e që janë në sipërfaqja prej S=26,324.00m², nuk janë trajtuara, gjegjësisht të njëjtat mbeten pa trajtuar dhe në pronësi / posedim të P.SH, Kuvendi Komunal i Prishtinës;

Nëse i referohemi sipërfaqes së Bllokut urban "B-5" të planit rregullues, e cila sipas këtij plani ka sipërfaqen e gjithmbarshme prej S=76,601.90m² dhe sipërfaqen e parcelës ndërtimore të trajtuar

me këto kushte ndërtimore për RTK-ën e që është $S=61,135.00m^2$, konstatohet se sipërfaqja prej $S=76,601.90 - 61,135.00=15,466.90m^2$, mbetet për trajtim në fazat e ardhshme të planit rregullues, duke përfshi edhe pjesët e parcelave kadastrale nr.556-1 ZK Çagllavicë me pronar / posedues P.SH. KK Prishtinë, pjesa e parcelës nr.1014-1 ZK Matiçan me pronar / posedues "KBI Kosova" në menaxhim të AKP-së, si dhe pjesa e parcelës nr.1014-2 ZK Matiçan me pronar posedues Ardit Rexha (për të cilat parcelë mungojnë shënimet e ndarjes), të cilat parcela pjesërisht janë të destinuara për ndërtim kurse pjesërisht në hapësirë publike - gjelbërim;

Gjithashtu, nëse i referohemi shkresave të shkëmbyera përmes postës elektronike, me zyrtarët e AKP-së të datave 02.10.2019, 03.10.2019, 10.10.2019, 11.10.2019, 18.10.2019, 30.10.2019, 31.10.2019, 01.11.2019 dhe 04.11.2019, konstatohet se përgjegjësit e AKP-së janë informuar për këtë çështje dhe se të njëjtit janë pajtuar që projekti i RTK-së të realizohet sipas projekt propozimit dhe planit rregullues. Andaj bazuar në kompetencat ligjore që i përcakton rregullativa ligjore në fuqi konkretisht diskrecionin në vendosje të çështjes, kjo drejtori vendosi të shqyrtoj dhe merr vendim - vendosë sipas kërkesës për kushte ndërtimore 05nr.350/02 - 223693/19 dt.11.09.2019, kurse pronarët / poseduesit e parcelave kadastrale nr.556-1 ZK Çagllavicë me pronar / posedues P.SH. KK Prishtinë, pjesa e parcelës nr.1014-1 ZK Matiçan me pronar / posedues "KBI Kosova" në menaxhim të AKP-së, si dhe pjesa e parcelës nr.1014-2 ZK Matiçan me pronar posedues Ardit Rexha, përmes shkresës "Informim" 05nr.350/02 - 223693/19 dt.13.12.2019 të informoj të lartë cekurit, për vendimin dhe të njëjtit të kenë drejt që të ndër marrin mjetin juridik bazuar në pjesën udhëzimin juridik të përcaktuar në aktin administrativ, nëse konstatojnë se të njëjtëve u janë cenuar të drejtat ligjore .

Në analizën e situacionit nga aspekti i komunikacionit dhe prezantuar në shkresën e zyrtarit – ekspertit për komunikacion, janë përcaktuar masat që duhet të ndërmerren, për kyçje të kompleksit me rrugën e brendshme të bllokut, me rrugën të planifikuar të planit rregullues urban, ku ndër të tjera konstatohet:

Pas shikimit të propozimit të situacionit të zgjidhjes urbane të Ndërtesës së Radio Televizionit të Kosovës, në lagjen "Prishtina e re, zona Qendër" të Prishtinës, lidhur me kërkesën për kushte ndërtimore të lëndës nr. 05-350/02-223693/19 të dt. 11.09.2019, kyçjet për automjete në rrugën e planifikuar sipas planit rregullues Prishtina e re, zona Qendër - "krahu 11", për Ndërtesat e Radiotelevizionit të Kosovës, me etazhitet S+P+3, hapësirat e vend-parkingjeve dhe shërbimeve tjera të kësaj zone, mund të pranohen si të tilla, bazuar në kategorinë e rrugës dhe shmangies së këtyre kyçjeve në raport me udhëkryqet e rrugëve të planifikuara. Gjithashtu kyçja e kësaj hapësire me këtë zgjidhje urbane në rrugën "krahu 2", është bërë simetrisht në raport me rrugën "krahu 7", përmes së cilës i ipet mundësia për kyçje edhe hapësirës së bllokut A, në mënyrë që të mos aplikohen më shumë kyçje në rrugën kryesore "krahu 2", dhe të ruhet funksioni dhe siguria e pjesëmarrësve në komunikacion në këtë rrugë. Kyçjet duhet ti përshtaten teknikisht rrugëve të planifikuara dhe të aplikohen kushtet e shikueshmërisë horizontale dhe vertikale në lokacionin e kyçjeve edhe në kohën kur realizohen ato.

Andaj, si konkludim përfundimtar, bazuar në konstatimet e më sipërme, dokumentacionin e prezantuar dhe shqyrtuar, konsultimin e rregullativës ligjore në fuqi, konkretisht nenit 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 31.07.2013, nenit 18 të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L-110 dt.31.05.2012, nenit 13 të "Udhëzimi Administrativ i MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve", si dhe diskrecionin për vendose të çështjeve të planifikimit dhe ndërtimit në bazë të nenit 21, 44, 57 & 140 të LPPA-së Nr.05/L - 031 dt.21.07.2016, lidhur me ligjshmërinë për caktimin e kushteve ndërtimore, Drejtorja e Urbanizmit vendosi që ta miratoj kërkesën për kushte ndërtimore me faktet – provat e prezantuar ta trajtoj sipas rregullativës ligjore në fuqi, me që rast të konstatoj se kërkuesit kanë prezantuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, se plani i situacionit-"zgjidhja urbane", është në harmoni me destinimin dhe kriteret tjera të planit rregullues urban për atë hapësirë, si dhe në harmoni me rrethinën, andaj konstatohet se janë plotësuar të gjitha kriteret e parapara ligjore për caktimin e këtyre kushteve ndërtimore.

Njëherë përmes shkresës, "Njoftim" 05nr.350/02-223693/19 dt.13.12.2019, kjo drejtori vendosi që bazuar në rregullativën ligjore në fuqi, konkretisht Ligjit Nr.03/L-215 për qasje në dokumente publike, palët e interesuara, Agjencinë Kosovare të Privatizimit – AKP dhe pronarit të parcelës kadastrale nr.1014-2 ZK Matëçan me pronar / posedues, Ardit Rexha nga Prishtina, që përmes kërkesës drejtuar në Komunën e Prishtinës, mund të kenë qasje në dokumente publike, konkretisht në vendimin e kushteve ndërtimore të lartë cekura.

Nga sa u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të vendimit të kushteve ndërtimore.

Shtojcë: Plani i situacioni - "zgjidha urbane" e kompleksit me ndërtesa të planifikuara dhe hapësirat përcjellëse; Situacioni i parcelës kadastrale në raport me rrugët e planifikuara, si dhe vijën ndërtimore & rregulluese nga Planit Rregullues "Prishtina e Re – Zona Qendër" në Prishtinë, në sistemin koordinativ KosovaREF 01; Manuali i ndarjes së parcelës kadastrale nr.556-5 ZK Çagllavicë .

Udhëzim juridik: Pala e pakënaqur me vendimin e kushteve ndërtimore, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtyre kushteve ndërtimore. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPH-ja.

I dërgohet: Kërkuesve, Qendrës për shërbim me qytetarë, kësaj drejtorie dhe në dosje të lëndës, 05nr.350/02 – 223693/19 dt.11.09.2019.

I dërgohet përmes postës elektronike: Drejtorisë për Pronën, Drejtorisë për Kadastër, Drejtorisë për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave, Drejtorisë për Planifikim Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR.350/02 – 223693/19 DT. 13.12.2019**

Zyrtari:
Ergyn Hajredini

U.D. Udhëheqëse e Sektorit:
Mimoza Berisha Prestreshi





Investitor:



Republika e Kosovës
 Republika Kosovo-Republic of Kosovo
 Qeveria-Vlada-Government
 Ministria e Administratës Publike
 Ministarstvo Javne Uprave - Ministry of Public Administration

RADIO TELEVISIONI I KOSOVES



Projektues: ALB ARCHITECT PRISHTINE

DESIGN
 CONSTRUCTION
 PROJECT MANAGEMENT
 TECHNICAL CONSULTING
 PROJEKTIM
 NDERTIM
 MENAXHIM TË PROJEKTIT
 KONSULTIME TEKNIKE



PROJEKT KONCEPTUA



Emri i Projektit:

OBJEKTI I RADIO TELEVISIONIT TË KOSOVËS - RTK

Lokacioni:

PRISHTINË

Vizatimi:

ZGJIDHJA URBANE E PROPOZUAR

OBJEKTI:

RTK
 B+S+P+3

2019




Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic Of Kosovo
 Komuna e Prishtinës
 Opstina Pristina - Municipality Of Prishtina



DREJTORIA E URBANIZMIT

SITUACIONI I PARCELAVE ME VIJEN NDERTIMORE DHE RREGULLUESE NGA PLANI RREGULLUES NE SISTEMIN KOORDINATIV KOSOVAREF01




Punoi:
 Kushtrim Domaneku.

Nënshkrimi: _____

Prishtinë: 09.12.2019

Legjenda:

- Vija Rregulluese sipas PRRL
- Parcelat Kadastrale



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor / Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja / Ministry of Environment and Spatial Planning

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

Zyra kadastrale komunale / Opštinska katastarska kancelarija: Prishtinë

Nr. i njësisë kadastrale / Br. katastarske jedinice: 355-6


Zona kadastrale / Katastarska zona: Qagllavice

Numri i lëndës / Broj predmeta: 04/2019

Lloji i njësisë kadastrale / Vrsta katastarske jedinice: Parcel

Shkalla e zvoglimit / Razmera plana 1: 2500

KOORDINATAT PARCELES		
n	y	x
1	7514745.32	4721607.10
2	7514765.89	4721573.09
3	7514773.34	4721618.30
4	7514780.56	4721622.64
5	7514784.58	4721569.62
6	7514806.57	4721637.76
7	7514812.77	4721641.94
8	7514818.92	4721792.49
9	7514823.34	4721782.89
10	7514826.61	4721776.12
11	7514830.69	4721766.59
12	7514840.44	4721744.05
13	7514840.60	4721704.64
14	7514841.40	4721713.49
15	7514843.88	4721736.52
16	7514845.63	4721680.48
17	7514849.18	4721664.19
18	7514850.21	4721556.86
19	7514851.38	4721798.53
20	7514896.74	4721807.52
21	7514912.10	4721529.00
22	7514949.72	4721819.25
23	7514952.51	4721498.71
24	7514984.60	4721464.51
25	7514994.08	4721446.64
26	7515014.63	4721461.42
27	7515032.12	4721839.54
28	7515047.14	4721494.74
29	7515067.47	4721843.85
30	7515075.36	4721540.45
31	7515124.68	4721846.33



KOORDINATAT OBJEKTI		
n	y	x
1	7514922.61	4721665.85
2	7514927.10	4721659.65
3	7514929.90	4721661.68
4	7514934.98	4721654.67
5	7514935.87	4721684.31
6	7514937.55	4721656.74
7	7514940.10	4721678.53
8	7514945.15	4721649.06
9	7514947.90	4721693.07
10	7514952.12	4721637.24
11	7514959.19	4721701.26
12	7514963.42	4721695.43
13	7514964.48	4721715.88
14	7514966.69	4721679.41
15	7514969.61	4721708.81
16	7514972.16	4721683.38
17	7514975.12	4721667.79
18	7514984.82	4721730.63
19	7514989.01	4721660.09
20	7514989.95	4721723.55
21	7514995.82	4721645.13
22	7514997.23	4721648.80
23	7514998.17	4721647.20
24	7514999.84	4721638.89
25	7515000.36	4721731.11
26	7515001.37	4721640.01
27	7515001.76	4721639.47
28	7515013.04	4721713.62
29	7515018.22	4721616.77
30	7515020.11	4721727.64
31	7515021.78	4721701.56
32	7515024.33	4721721.81
33	7515030.21	4721689.94
34	7515032.13	4721736.35
35	7515033.07	4721709.75
36	7515036.36	4721730.52
37	7515038.80	4721678.94
38	7515041.50	4721698.12
39	7515053.84	4721743.20
40	7515058.24	4721719.15
41	7515060.08	4721734.59
42	7515062.30	4721648.73
43	7515062.47	4721713.32
44	7515067.24	4721725.68



Rilevoi / Snimio: INFA & Co.GROUP

(emri dhe mbiemri i gjeodetit / kompanisë / ime i prezime geodeta/kompanije)

Nr. i licencës / Br. licence: 17

Nënshkrimi / Potpis: *[Signature]*

Data e rilevimit / Datum snimanja: 05.12.2019

V.V.

Aprovoi / Usvojio: _____

(emri dhe mbiemri i gjeodetit / kompanisë / ime i prezime geodeta/kompanije)

Nënshkrimi / Potpis: _____

Data e aprovimit / Datum usvajanja: _____